Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

*****Shënim: Për kryerjen e verifikimeve përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në shtojcën 4, lutemi të plotësoni të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:**

Emër, Atësi, Mëmësi, Mbiemër, Ditëlindje

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, te leshuar jo me heret se 30 dite nga data e hapjes se ofertes*

h. *Grafikun e punimeve.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Është përshkruar në Kriteret e përgjithshme të Pranimet/Kualifikimit.

2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.1 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

2.2 Xhiroja mesatare vjetore për vitin **2017, 2018 dhe 2019** duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se **6,080,114 (gjashtë milion e tetëdhjetë mijë e njëqind e katërbëdhjetë) lekë (50 % e fondit limit pasi është procedurë mbi kufirin e ulët monetar).**

2.3 Kopje të certifikuar të bilancit të viteve **2017, 2018 dhe 2019** të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet.

3. Per kapacitetin teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej jo me pak se **6,080,114 (gjashtë milion e tetëdhjetë mijë e njëqind e katërbëdhjetë) lekë**, dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e dorëzimit te ofertes.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjate tre viteve të fundit nga data e dorezimit të ofertës të paktën një vlerë prej **24,320,455 (njëzetë e katër milion e treqind e njëzetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) lekë ;**

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën Ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ku të shënohet vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi **vërtetime** ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e **shoqëruar me fatura tatimore** dhe dokumentat e sipërsënuar nga **ne iii për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

1. Liçensat profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës , referuar preventivit të punimeve si dhe llojit të punimeve të parashikuara në të duhet të ketë këto pika në licencën profesionale :

➤ **N.P.1: Punime germimi në toke** **“Kategoria A”**

Perfshijne punimet e germimit, nivelimit dhe sistemimit të terrenit ,sipas preventivit

➤ **N.P.4: Rrugë autostrada, ura, mbikalime etj.** **“Kategoria A”**

Perfshin në menyre të thjeshtuar rruget, shtresat dhe nenshtresat e saj dhe të gjithë proceset e punëve që kanë të bëjnë me trasenë e rrugës , duke filluar nga skarifikimet e shtresave rrugore, kanalizimet për shtrimin e linjave të ndicimit rrugor, (Ketu perfshihen vetem proceset ndertimore , jo ato të specializuara) . Perfshihen Strukturat e trotureve, nenshtresat të ndryshme si dhe ato me funksion konturues.

➤ **N.P.5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti** **“Kategoria A”**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësimi ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Ne objektin në fjalë, për procedurat e punës së ndertimit të mureve mbajtës b/a për mbajtjen e dherave të trasës së rrugës në rast se do të dale e nevojshme gjate zbatimit të projektit.

➤ **N.P.7: Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje** **“Kategoria A”**

Per punimet e riparimit të linjave të ujesjellesit, kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza që mund të demtohen gjate punimeve të zbatimit të projektit.

➤ **N.P. 12: Punime të inxhinierisë së mjedisit** **“Kategoria A”**

Perfshijne zbatimin e punimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

➤ **N.S. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve** **“Kategoria A”**

Per procedurat e punes te prishjes se gjithe objekteve dhe ndertimeve te paparashikuara qe pengojne zbatimin e punimeve te projektit, brenda gjurmes se ndertimit ku do te implementohet projekti.

➤ **N.S.4: Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj.** **“Kategoria A”**

Perfshijne proceset e punes te nevojshme per riparimin e te gjithe demtimeve te mundshme ne murret rrethuese dhe objektet e tjera ekzistuese.

➤ **N.S.5. Impjiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut** **“Kategoria A”**

Prerfshijne punimet e ndricimit rrugor te parashikuara ne projekt, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare

➤ **N.S.18: Punime Topogjeodezike** **“Kategoria A”**

Perfshin procedurat e punes pergatitore te parashikuara , ato te rikonjicionit, matjeve te situacionit si dhe te piketimit te gjithe gjatesise se rruges qe ndertimit.

2. Dëshmitë për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

• Kamion veteshkarkues kapacitet mbajtës mbi/ose 15 ton	cope 2 (dy)
• Kamion veteshkarkues kapacitet mbajtës (8 deri ne 10 ton)	cope 1 (nje)
• Kamociene kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	cope 1 (nje)
• Autovinc	cope 1 (nje)
• Eskavator me zinxhire/goma	cope 1 (nje)
• Rimorkiator	cope 1 (nje)
• Grejder	cope 1 (nje)
• Skrep	cope 2 (dy)
• Mini fadrome	cope 1 (nje)
• Fadrome	cope 1 (nje)
• Auto-Betoniere	cope 2 (dy)
• Betoniere	cope 2(dy)
• Autobot uji	cope 1 (nje)
• Autobitumatrice	cope 1 (nje)
• Asfaltoshtruese	cope 1 (nje)
• Rul me vibrim	cope 1 (nje)
• Vibrator betoni	cope 1(nje)
• Matrapik	cope 4 (kater)
• Tokmak per ngjeshje dheu	cope 4(kater)
• Pirun deri ne 1.5 ton	cope 1(nje)
• Kontinier stacioner	cope 1 (nje)
• Depozite per grumbullim materiale	cope 1(nje)
• Gjenerator 3.5kW	cope 1(nje)

Paisje per mbrojtjen ne pune.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------|
| ○ Kokore dhe pajisje personale | cope 30 (tridhjet) |
| ○ Tabela sinjalizuse | cope 18 (tetembedhjete) |
| ○ Kuti te ndihmes e se shpejte | cope 15 (pesembedhjete) |
| ○ Prozhektore per ndricim | cope 10 (dhjete) |

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

a) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

3. Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese qe makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

4. Në lidhje me fuqinë punëtore të operatorit ekonomik kërkohet :

Për realizimin e punimeve kërkohet që shoqëria pjesëmarrëse të ketë mesatarisht 24 (njetzet e kater) punonjës për periudhën **Gusht 2020 - Nentor 2020**, duke përfshirë stafin e përhershëm:

➤ *Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*

➤ *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

5. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të pasqyruar në listëpagesa (per periudhen **Gusht 2020 - Nentor 2020**) të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ish IQT ose ekuivalentet e tij) dhe kontrata e punes e vlefshme

- Teknike ndertimi 1 (dy)
- Specialiste/Karpentier 2 (dy)

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

➤	Pllakashtrues	2 (dy)
➤	Elektriciste	1(nje)
➤	Hidraulike	1 (nje)
➤	Puntore te thjeshte	6 (gjashte)
➤	Shofere	2 (dy)
➤	Manovratore	4 (kater)

Për punonjësit teknik ndërtimi te paraqiten edhe dokumentat qe vërtetojnë kualifikimin (dëftesë dhe/ose diplome), te leshuar nga organet shtetërore .

Për Manovratorët të paraqiten dëshmitë përkatëse të aftësisë profesionale, te figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Gusht 2020 - Nentor 2020** per makinerite qe jane ne pronesi ose kontratat e punës të vlefshme ne rastin kur makinerite disponohen me qera.

6. Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj drejtues (ne licensen e shoqerise):

✓	Inxhinier ndertimi	1(nje)
✓	Inxhinier elektrik	1(nje)
✓	Inxhinier hidroteknik	1(nje)
✓	Inxhinier gjeodet	1(nje)
✓	Inxhinier Mjedisi	1(nje)

6.1 Te gjithë punonjesit e kerkuar sipas pikes 6, te jene te shoqeruar me diplome, kontrata pune, CV dhe librezë pune.

6.2 Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi, ing. elektrik, ing.gjeodet dhe ing.mjedisi) duhet te jene drejtues teknike ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhën **Gusht 2020 - Nentor 2020.**

6.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori i shoqerise pjesemarrëse ne kete prokurim, qe stafi i inxhinierëve, te kerkuar me siper, jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera.

7. Operatori ekonomik ofertues duhet qe nje nga drejtuesit teknik te permbush kriterin per te qene koordinator ne fushen e sigurise dhe shendetit ne pune dhe qe të disponoj dëshmi trajnimi si ” **Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet **certifikata e trajnimit për ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**”e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës si dhe duhet të jetë i përfshirë në listëpagesën e shoqërisë per periudhën **Gusht 2020 - Nentor 2020**.

Shenim: Argumentimi mbi numrin e punonjesve.

Ne objektin “**Rikonstruksion I rruges se varrezave, Dukas**” proceset e punes klasifikohen ne keto kategori:

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

a) Punime per mobilizimin e kantierit

Ne keto punime perfshihet pergatitja e kantierit per fillimin e punimeve. Gjate kesaj kohe do t percaktohen furnitoret dhe vendet e depozitimit te materialit. Do te stukturohet organika e njerezve qe do te punojne ne kantier dhe do te behet konturimi i kantierit me hyrjedaljet e tij. Afati i parashikuar 7 dite kalendarike. Puntore te angazhuar: 2 puntore. Makineri Kamiocine dhe/ose pick-up.

b) Punime topografike

Afati i punimeve te rikonjcionit (piketimi i objektit) 3 dite + 3 dite hedhja e materialit te rilevuar ne leter dhe perpunimi i te dhenave per fillimin e projektit. Volumi i punimeve: 640 ml rilevim rruge. Puntore te angazhuar:1 ing.topograf 2 puntore. Mjete te angazhuara: 1 kamiocine dhe/ose 1 pick-up.

c) Punime germimi e mbushje me volum mesatar 600 m3

Për afat punimesh të parashikuara 3 javë (21 ditë) dhe normë orare punimi prej 0.41ore/m³, koha e nevojshme për gjithë volumin e punës është : 0.41 x 611.42=249 ore ose e përkthyer në ditë pune 11.85 orareshe , 21 ditë pune. Për një periudhë 21 ditore , kapaciteti teknik-mekanik duhet të jetë 1.2 here i kapacitetit nominal. Kërkesa duhet 2 mjete të punimit të dherave (ekskavator), 2 Kamiona, 1 autobot uji dhe 1 tokmak per ngjeshjen e dheut. Gjithesej 2 manovratore (2 eskavatorist + 2 shofere)

d) Punime shtresash rrugore komplet me vlere mesatare 2826.1 m2

Orari nominal mesatar per shtresat rrugore (te 4 shtresat) shkon ne rreth 0.49 ore/m². Per 2826 m² , shkon ne rreth 1380 ore ose 138 dite pune. Referuar grafikut qe parashikon 3 jave ose 21 dite, fuqia puntore duhet te jete 6.6 here me shume, ose 2sp+ 6 puntore. Makinerite qe nevojiten jane: 1 bitumatrice + 1 asfaltoshtruese+1rul me kompresor+4 kamiona.gjithesej 2 specialiste + 6 puntore + 3 manovratore + 4 shofere.

e) Punime shtresa trotuari me volum mesatar 125 m2

Parashikimi per kete kategori punimesh shkon ne 2 jave ose 12 dite pune. Referuar normative per ml (perfshire bordura + trotuar vetshtrengues + shtresa) 5.77 ore/m² , koha totale e punes shkon ne 721 ore. Referuar Kohes ditore prej 10 oresh, ekuivalentohet ne 72 dite. Per afat prej 12 ditesh , duhen gjashte fishuar fuqia puntore dhe mjetet , kundrejt sasise nominale. Perfundimisht per kete proces pune, brenda afateve duhen 2 specialist + 5 puntore + 2 shofere.

f) Punime elektrike.

Ne kete kategori punimesh perfshihen nje sere zerash si: shtrimi i tubove dhe linjave elektrike dhe vendosja e shtyllave te ndricimit ne nje gjatesi 125ml (gjatesia e trotuarit). Ne kete proces pune duhet te angazhohen 3 elektriciste + 1 specialist + 2 puntore. Ne total eshte parashikuar qe keto punime te zgjasin rreth 2 jave ose 12 dite pune. Per realizimin e punimeve brenda ketyre afateve duhen a 3 elektriciste + 1 specialist + 2 puntore + 2shofere.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- **4 manovrator**
 - **Grejderi;**
 - **Fadrome**
 - **Ruli;**
 - **Bitumatrice+asfaltoshtruese etj,**
- **2 shofere**
- **2 specialiste**
- **2 pllaka shtrues**
- **1 elektricishte**
- **1 hidraulik**
- **6 puntore**
- **5 drejtues Teknik**
- **1 teknik ndertimi.**

TOTALI = 24 Persona ne Staf.

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndaria sipas specialitetev ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

8.Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve

Neni 12 Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve te ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

9. Shoqeria duhet te jete e pajisur edhe me çertifikatat e meposhtme:

- a) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- b) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001 - 2004 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- c) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007 ose ekuivalenten e saj ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme)** (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS / ISO).
- d) Certifikate **ISO 99-2012 - Sistemi i Menaxhimit të Integruar (e vlefshme)** (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS / ISO).

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- e) Certificate **ISO 28001:2007 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise per zinxhirin e funizimit (e vlefshme)** (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS / ISO).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve: 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Objekti : Rikonstruksion i rrugës së Varrezave ,Dukas.

Nr.	Nr. Anal.	Emertimi Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
A.Punime rikonstruksioni						
<i>I. Punime Germimi</i>						
1	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	305.71		
2	3.47/1b	Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak cdo 30 cm, toke e zak	m ³	259.15		
3	2.37/2a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km	m3	46.57		
Shuma 1						
<i>II. Punime shtresash</i>						
1	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	2826.10		
2	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	2826.10		
3	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave, t=5cm,me makineri	m2	2826.10		
4	3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	2826.10		
5	3.212/b	Bankine, Shtrese stabilizant t=10cm	m2	470.00		
Shuma 2						
<i>III. Punime trotuari</i>						
1	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15 (per kunete)	m3	5.00		
2	2.262/1	Shtrese betoni C 7/10 per mberthim bordure	m3	17.50		
3	2.290	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	ml	250.00		
4	2.288	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit	m2	125.00		
5	2.261	Shtrese rere per fugat e trotuarit	m3	5.00		
6	3.183/b	Shtrese zhavor lumi t=15cm	m2	125.00		
Shuma 3						

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

IV. Punime elektrike						
1	3.An/1sh	FV shtylla metalike konike ndricimi H=8m PAICC-3	cope	5		
2	3.An/ksh	FV krah shtylla metalike KRH - MSI	cope	5		
3	3.An/55	FV Montim koke LED me nje krahe perfshire te gjithe aksesoret e nevojshem.	cope	5		
4	An	F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	cope	1		
5	4.131/3.5	F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ±1000V, me izolim gome e mbulesese plastmasi, 4x10mm ²	ml	1		
6	An	F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ±1000V, me izolim gome e mbulesese plastmasi, 4x6mm ²	ml	170.00		
7	An	F.V Tubo plasmasi fi 63	ml	200		
8	An	F.V Tubo plasmasi fi 40	ml	10		
9	2.a-93	F.V Tel Cu togezimi 16mm ²	ml	10		
		Shuma 4				
		Shuma 1-4				
		Fond rezerve		0%		
		Vlera e puneve pa TVSH				
		TVSH		20%		
		TOTALI (Shuma me TVSH)				

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstrukcion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

Dokumenta Standarde të Tenderit
Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, Dukas.

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
